



04.07.2002

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA X E KUVENDIT TË KOSOVËS
MBAJTUR ME 4.VII.2002

Mbledhja filloi me punë në ora 10.00

Mbledhjen e kryesoi: Kryetari i Kuvendit Akademik **Nexhat Daci**, anëtar i Kryesisë
z.Bajram Kosumi dhe Sekretari i Kuvendit **z. Frank Boulin**.

Kuvendi i Kosovës, para fillimit të seancës, mbajti një mbledhje komemorative për **Bedrush Çollakun** deputet i LPK-së, vdekjen e të cilit Kryetari i Kuvendit **z.Nexhat Daci** e quajti humbje për Kuvendin. Për jetën e deputetit **Çollaku**, foli **z.Bajram Kosumi**. Ai tha se **Çollaku** në fillim të viteve 60-ta zhvilloi aktivitetet në grupet e fshehta patriotike. Në vitin 1969 arrestohet nga regjimi serb dhe pesë vite mbahet në burgun e Nishit. Ai arrestohet dhe mbahet në burg edhe dy herë, 1979 dhe vitin 1981. Pas vitit 1981 ishte në udhëheqësi të Partisë Parlamentare të Kosovës, pastaj si veprimtar i Lëvizjes Popullore të Kosovës, i angazhuar në ndihmën e zgjerimit të UÇK-së, ndërsa pas luftës ishte ndër udhëheqësit e lartë të Lëvizjes Popullore të Kosovës. Në zgjedhjet 2001 ai zgjidhet deputet i Kuvendit të Kosovës. Kuvendin e Kosovës, për vdekjen e deputetit **Çollaku** e ka ngushëlluar edhe Gjeneral **Agim Çeku**, Komandant i TMK-së. Kryetari i Kuvendit konstatoi se në mbledhje janë të pranishëm shumica e deputetëve për vendosje të plotëfuqishme dhe për mbledhjen e sotme propozoi këtë:

R e n d i t e

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i Projektligjit mbi Pensionet në Kosovë.
3. Propozimi i Rezolutës mbi të drejtat e Komuniteteve dhe anëtarëve të tyre dhe mbi kushtet e kthimit të të zhvendosurve dhe refugjatëve.

Meqë nuk ka patur vërejtje në rendin e ditës, i njejtë është aprovuar.

I

Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Deputeti **Gojko Saviç**, dha vërejtje se është ndryshuar rendi i ditës, nga ajo që është paraparë në Kryesinë e Kuvendit. Deputetja **Liljana Keniçi** kërkoi që të shtyhen pikat e rendit të ditës